

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Komunes se Gjilanit**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

| | |
|------------------------------|--------------------|
| Nr ¹ i prokurimit | 651-24-11889-5-2-1 |
| Nr i brendshëm | |

Sa i përket tenderit me titull: "Ndërtimi I rrugeve në fshatrat Lipovicë, Myqibabë dhe Depcë"

ANKESË

Emri i plotë i kompanisë:

EL-BAU SH.P.K

Adresa:

Rruga Vëllezërit Hyseni, nr. 57

Vendi:

Gjilan

Kodi postar:

60000

Numri Telefonit:

049 244 330

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj:

Fatlum Pireva

Adresa elektronike:

shpkelbau@gmail.com

Data e parashtrimit të ankesës

28 maj 2026

Nënshkrimi dhe vula:



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

| Data | Përshkrimi i kronologjisë procedurale të aktivitetit |
|------------|---|
| 12.11.2024 | Publikimi i Njoftimit për Kontratë - procedurë e hapur, Vlera totale e parashikuar: 124,000.00 € Kriteri për dhënie: Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët. |
| 03.12.2024 | Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve |
| 30.04.2026 | Njoftim mbi Vendimin e AK per anulimin e aktivitetit te prokurimit |
| 05.05.2026 | Parashtrimi i Kërkesës për Rishqyrtim nga EL-BAU sh.p.k pranë AK- KK Gjilan |
| 18.05.2026 | Vendimi i AK per refuzimin si te pabazuar te Kerkeses per Rishqyrtim |
| 25.05.2026 | Dokumente te siguruar nga dosja e OE ECO HOLDING dhe te dhënat tjera te aktivitetit te prokurimit gjatë seancës së qasjes zyrtare |
| 27.05.2026 | Parashtrimi i ankesës ne OSHP |

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Jo. Per faktin se sipas nenit 35.1 te RRPP, hapja e tenderit kryhet duke përdorur funksionalitetin e hapjes së tenderit në sistemin elektronik të prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Më datë 05.05.2026, kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim, me objekt kryesor per anulimin e vendimit te AK , i datës 30.04.2026, me të cilin AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit ne fjale, dhe me propozim per vazhdimin e procedurës ligjore për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e Tenderëve në pajtueshmëri me parimet themelore dhe dispozitat e nenit 59 dhe 60 lidhur me nenin 1,6,7 dhe 24 te LPP dhe dispozitave te ndërlidhura qe rregullojnë situatat e tilla te RRPP.

Megjithatë, AK – Komuna e Gjilanit, me vendimin e datës 18.05.2026, e ka refuzuar kërkesën si të pabazuar, duke e lënë në fuqi vendimin për anulimin e aktivitetit.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Parashtruesi konsideron se akti i kontestuar për anulimin e aktivitetit të prokurimit, duke përfshirë edhe veprimet që i kanë paraprirë dhe e kanë shkaktuar këtë vendim të paligjshëm, janë nxjerrë në kundërshtim me parimet e sigurisë juridike dhe dispozitave ligjore te LPP Nr. 04/L-041 (Versioni i Konsoliduar) dhe RRPP Nr. 02/2024 (Versioni i Konsoliduar), si me poshte:

- **Nenin 62** i LPP i lidhur me nenin 43 paragrafi 5 i RRPP
- **Nenin 9** ne paragrafin 5 te LPP lidhur me nenin 8 te RRPP

si tërësi me dispozitat

- **Nenin 1** në paragrafin 2 dhe 3 i LPP lidhur me nenin 4.3 i RRPP;
- **Nenin 6** në paragrafin 1 lidhur me nenin 4.3 ne pikat c, f, g të RRPP;
- **Nenin 7** në paragrafin 1, 2, 4 i LPP lidhur me nenin 4.3 ne pikat c, f, g të RRPP;
- **Nenin 24** në paragrafin 2 të LPP
- **Nenin 59** në par. 4 të LPP lidhur me nenin 39 dhe nenin 40 par. 1, 2.1, 6 të RRPP
- **Nenin 60** në paragrafin 1.1 të LPP lidhur me nenin 40 ne paragrafin 13 te RRPP;
- **Nenin 108/A** në paragrafin 6 dhe 9 të LPP lidhur me nenin 61(3) dhe 62(2) te RRPP;

Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative:

- **Nenin 48** i LPPA;

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Rrethanat procedurale të aktivitetit në fjalë.

- Me 12.11.2024, Komuna e Gjilanit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar në procedurë të hapur dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i rrugëve në fshatrat Lipovicë, Myqibabë dhe Depcë", me numër të prokurimit 651-24-1189-5-2-1, me vlerë të parashikuar prej 124,000.00€.
- Parashtruesi i kërkesës, GOE El-Bau Sh.p.k. & Eing – Com Sh.p.k., ka qenë ofertues me çmim total prej 119,763.68€ në tenderin e përshkruar si më lartë, duke i plotësuar në tërësi të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit. Gjithashtu në këtë aktivitet ka marrë pjesë edhe OE "Eco Holding Group" Sh.p.k. nga Gjilani.
- Me datë 30.04.2026, ZPP i AK-së, në kundërshtim flagrant me çdo praktikë dhe standard ligjor ka nxjerrë vendim me të cilin e ka anuluar aktivitetin e prokurimit, duke u thirrur në arsyetimin se Njësia Kërkuese ka konfirmuar se nuk mund të vazhdohet me procedurën e prokurimit sepse nuk janë të përfshira të gjitha rrugët në pozicione dhe kërkesat e banorëve.
- Për këto arsye, me 05.05.2026 ju kemi derjtuar AK – Komunës së Gjilanit me kërkesë për rishqyrtim me pretendimin kryesor për anulimin e vendimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit, me qëllim që të ndalet këtu kjo paligjshmëri e qëllimshme që tejklalon çdo kufi nga aspekti i qasjes jo ligjore dhe etikës publike sipas Kodit Etik dhe deklaratës nën betim (D02). Ngase vendimi i ankimuar është i kundërligjshëm, për shkak se arsyeja në të cilën thirret ZPP i AK nuk përbën kërkesë ligjore të parashikuar nga LPP si ligj material, as nga RRPP. Për pasojë, parashtruesit të kërkesës si palë me interes të drejtpërdrejtë material nga rezultati i këtij aktiviteti, i cenohet e drejta për vlerësim dhe krahasim të tenderëve në përputhje me parimet themelore dhe dispozitat e neneve 59 dhe 60 lidhur me nenin 1,6,7 të LPP, si dhe legjislacionin sekondar, RRPP dhe UPP.
- Megjithatë, ZPP i AK, me vendimin e nxjerrë më datë 18.05.2026, e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim në tërësi si të pabazuar, duke e lënë në fuqi vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Arsyetimi i vendimit nuk prezenton asnjë fakt, provë apo argument konkret me substance juridike dhe faktike që të mbrojnë ose justifikojë ligjshmërinë e vendimit të AK për anulim të aktivitetit të prokurimit, dhe nga ana tjetër nuk jep asnjë shpjegim se përse pretendimet tona janë të pabazuara. Arsyetimi mbetet i përgjithshëm, i kundërthënës dhe i shkëputur nga rrethanat faktike të çështjes, pa u mbështetur në dispozitat konkrete të LPP-së dhe RRPP-së;

- Për këto arsye, me anë të kësaj ankese i drejtohem OSHP-së, me qëllim mbrojtjen e të drejtës sonë ligjore, e cila mund të garantohet përmes një vendimi të drejtë dhe të ligjshëm nga ana e institucionit tuaj, në përputhje me nenin 104, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP-së.

2. Përshkrimi faktik dhe ligjor i pretendimeve ankimore

Pretendimi i parë

Pretendimi i parë, ndërlidhet me kundërshtimin e vendimit të Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE ankues, si vendim i pabazuar në fakte dhe në dispozita ligjore, dhe nga ana tjetër me shkeljet tjera që kanë ndodhur gjatë administrimit të këtij procesi nga AK, që për OE ankues janë bërë të ditura pas realizimit të qasjes zyrtare në të dhënat e aktivitetit të prokurimit.

1. Zyra e Prokurimit e AK – Komunës së Gjilanit, me anë të vendimit të datës 18.05.2026, e ka refuzuar si te pabazuar kërkesën për rishqyrtim, dhe e ka vërtetuar Njoftim Vendimin e AK-së të datës 30.04.2026. Në arsyetimin e tij, Njësia e Prokurimit, thekson se Njësia Kërkuese ka konfirmuar se nuk mund të vazhdohet me procedurën e prokurimit sepse nuk janë të përfshira të gjitha rrugët në pozicione dhe kërkesat e banorëve.
2. Pas analizimit të vendimit të kontestuar në raport me të gjitha shkresat e lëndës lidhur me këtë aktivitet prokurimi dhe bazën ligjore në fuqi, OE ankues ka gjetur se, vendimi i kontestuar përmban të meta thelbësore për shkak të të cilave nuk mund të merret për bazë ligjshmëria e tij. Te metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të LPP, si ligj material, legjilacionit sekondar - RRPP e cila sqaron dispozitat e LPP, si dhe shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative, si ligj i veçantë për procedurën dhe veprimin procedural dhe material administrativ të organeve publike.

Në mënyrë më specifike, të metat thelbësore qëndrojnë në shkeljet ligjore si më poshtë:

Pika e parë e pretendimit të parë

3. Neni 48 i LPPA, si ligj material për procedurën administrative, si dhe neni 108/A në paragrafin 12 të LPP-së, si ligj material për prokurimin publik, përcaktojnë qartë se duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet dhe faktet vendimtare, duke përfshirë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë të drejtat dhe interesat ligjore të OE ankues, apo përbëjnë vendim të kundërt me pretendimet dhe faktet e palëve të interesuara.
4. Në rastin konkret, Vendimi i kontestuar bie ndesh me detyrimet ligjore të AK, pasi është juridikisht i paqartë dhe i kundërthënës në raport me gjendjen faktike të bazuar në të dhënat e aktivitetit të prokurimit, si dhe me faktet dhe provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsyet e konstatimeve faktike të mbështetura në fakte dhe prova juridikisht të vërtetuara, dhe as dispozitat ligjore konkrete mbi të cilat bazohet akti, siç e obligojnë shprehimisht nenet 1 dhe 24, lidhur me nenet 6, 7, 59, 60 dhe 62 të LPP, të cilat kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kontestuar

5. Në arsyetimin e vendimit të kontestuar, përfshirë Njoftimin e Vendimit të AK, arsyetimi i dhënë është i përgjithshëm dhe pa mbështetje juridike. Ai nuk bazohet në fakte dhe prova konkrete, por në supozime dhe qëndrime subjektive të Njesisë së Prokurimit, të cilat ngatërrojnë qëllimisht gjendjen faktike dhe bien në kundërshtim të drejtpërdrejtë me bazën ligjore në fuqi. Kjo qasje bie ndesh me parimin e sigurisë juridike, me parimin e barazisë dhe ligjshmërisë, si dhe me pritjet legjitime që çdo palë ka të drejtë t'i ketë ndaj veprimeve të organeve publike.

Përveç kësaj, me vendimin e kontestuar për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dhe vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe aktet që i kanë paraprirë, Njësia e Prokurimit i ka atribuar vetes kompetenca që nuk i takojnë dhe që bien ndesh me hierarkinë e normave ligjore, LPP si ligj material dhe RRPP si akt nënligjor, që përcaktojnë kushte uniforme dhe të detyrueshme të zbatimit, të cilat Njësia e Prokurimit nuk mund t'i anashkalojë dhe nuk mund të veprojë jashtë tyre.

6. Njëkohësisht, Njësia e Prokurimit të AK nuk ka shfaqur asnjë interes dhe ka hezitur të shqyrtojë pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim, si dhe faktet dhe provat e dorëzuara në mbështetje të saj, për të cilat ka detyrë dhe obligim sipas nenit 24 dhe nenit 108/A paragrafi 12 të LPP, në lidhje me nenin 48 të LPPA Nr. 05/L-031, në mënyrë që të respektojë të drejtat e ankuesit dhe të marrë një vendim të drejtë, të ligjshëm dhe në përputhje me pritjet legjitime dhe të arsyeshme të tij.

7. Prandaj, arsyetimi i përdorur si pretekst për anulimin e këtij aktiviteti, përveç që është në shpërputhje të plotë me gjendjen faktike dhe me kriteret ligjore të nenit 62 të LPP, paraqet një rast të krijuar artificialisht apo në mënyrë fiktive nga Njësia e Prokurimit, me qëllim të vetëm parandalimit e shpërblimit me kontratë të OE ankues EL-BAU. Ky konstatim bështetet nga fakti se komisioni i vlerësimit nuk e kishte miratuar me votë të mazhorancës raportin dhe rekomandimet për dhënien e kontratës OE ECO GROUP SH.P.K. **Ju lutem shihni si prove të bashkëngjitur raportin e komisionit vlerësues**

Ndërkohë kishin lindur edhe rrethana të reja, pasi OE ECO HOLDING GROUP që nga data 02.04.2025 nuk e kishte vazhduar validitetin e ofertës dhe sigurimin e tenderit në pajtim me nenin 29 dhe nenin 30 të RRPP. Kjo ka sjellë si rrjedhojë situatën juridike ku OE ECO HOLDING GROUP në asnjë mënyrë nuk mund të shpërblihet me kontratë, pasi në përputhje me keto dispozita operatorët ekonomikë që nuk e zgjasin validitetin e tenderëve të tyre refuzohen si të papërgjegjshëm.

Raste të tilla të krijuara artificialisht me imagjinimin e situatave fiktive, përbëjnë praktikë të shpeshtë të AK për anulimin e aktiviteteve të prokurimit pas hapjes së ofertave dhe në fazën finale të dhënies së kontratës, përmes justifikimeve të tilla apo të ngjashme. Për ilustrim, po sjellim dy raste konkrete me të cilat OE ankues EL-BAU është ballafaquar: *Renovimi i shtepse se kultures – Cernice – Ritenderim* me numer prokurimi 651-25-69478-5-2-1 dhe *Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadish*, me numër prokurimi 651-22-11-628-521

8. Si përfundim i pikës së parë të këtij pretendimi, konsidetojmë vendimi i kundërshtuar që ndërlihet me kundërshtimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të datës 30.04.2026, përbën shkelje të detyrimit të drejtpërdrejtë ligjor të parashikuar nga neni 24 dhe neni 108/A paragrafi 12 i LPP, në lidhje me nenin 48 të LPPA Nr. 05/L-031, të cilat e obligojnë AK që të shqyrtojë në mënyrë të plotë dhe të arsyetuar çdo pretendim ankimor, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë, të ligjshëm dhe në përputhje me pritjet legjitime të arsyeshme të ankuesit.

Pika e dytë e pretendimit të parë

9. Përveç shkeljeve ligjore të lartcekura, Njësia e Prokurimit ka shkelur edhe afatin procedural të përcaktuar në nenin 108/A paragrafi 6 të LPP. Kërkesa për rishqyrtim është parashtruar më datë 05.05.2026, ndërkohë që AK më datë 12.05.2026 na ka njoftuar se e shtynte afatin për tre ditë shtesë. Megjithatë, AK nuk e ka përfillur as këtë afat të zgjatur, duke marrë vendimin më datë 18.05.2026, pra me vonesë. OE konsideron se respektimi i afateve ligjore nuk përbën vetëm obligim procedural, por garanci themelore që lidhet drejtpërdrejt me procesin e rregullt ligjor dhe me pritjet legjitime të palëve. Prandaj edhe një veprim i tillë si ky i AK përbën shkelje të nenit 108/A paragrafi 6 të LPP.

Ju lutem shihni vendimi i AK per refuzim te kerkeses per rishqyrtim

Në vijim paraqiten pretendimet ankimore të parashtruara pranë AK nëpërmjet Kërkesës për Rishqyrtim të datës 25.03.2026, të cilat mbështeten në fakte konkrete dhe analiza ligjore që dëshmojnë shkelje të dispozitave përkatëse të LPP-së dhe akteve nënligjore në fuqi.

Pretendimi i dytë (Pretendimi i parë i Kërkesës për Rishqyrtim)

10. Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjilanit, përmes vendimit të saj, të datës 30.04.2026, ka vendosur që të anulohet aktivitetet e prokurimit "Ndërtimi I rrugeve në fshatrat Lipovicë, Myqibabë dhe Depcë", nr. Prok. 651-24-11889-5-2-1. Sipas vendimit të kundërshtuar me këtë kërkesë për rishqyrtim, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit të AK-MPB, pretendon se këtë vendim e ka marrë pasi që Njësia Kërkuuese ka konfirmuar se nuk mund të vazhdohet me procedurën e prokurimit sepse nuk janë të përfshira të gjitha rrugët në pozicione dhe kërkesat e banorëve.
11. Duke u nisur nga rrethanat e gjendjes faktike dhe duke u mbështetur në dispozitat e ligjit material LPP nga neni 62 lidhur me dispozitat e legjislacionit sekondar nga neni 43.5 i RRPP, të cilat përcaktojnë shprehimisht rastet kur AK mund të ndërpresë një procedurë prokurimi, rezulton se arsyeja në të cilën është thirrur ZPP nuk gjen zbatim në asnjërin nga këto dispozita. Sepse nuk ka ekzistuar asnjëra prej kriterëve të kërkuara nga dispozitat e lartcekura që do t'i mundësonte AK-së që të përfundojë - anulohet një aktivitet të prokurimit, si para ashtu edhe pas hapjes së ofertave e që do të rezultonte me mosdhënie të kontratës. Ngase një arsyetim i tillë nuk gjen mbështetje në nenin 62 të LPP i cili përcakton shumë qartë dhe në mënyrë taksative rastet se kur lejohet anulimi i një procedure pas hapjes së ofertave, dhe atë kur "një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh... e cila nuk mund të rregullohet" dhe kur "të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmim që e tejkalon buxhetin", ndërsa neni 43 i RRPP përcakton në 11 pika rastet pas hapjes së ofertave kur mund të bëhet ndërprerja e procedurës.
12. Në rastin konkret nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara me këtë dispozitë ligjore, çka nënkupton se vendimi për anulim është marrë pa bazë ligjore dhe në tejkalim të kompetencave të Autoritetit Kontraktues, duke e bërë këtë akt arbitrar dhe të pavlefshëm, pasi objekti i tij është ligjërisht i pamundur.

13. Në këtë kontekst, vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe arsyetimi i përdorur si pretekst - pas zvarritjes së panevojshme dhe të pajustificueshme të procedurës së vlerësimit për mbi një vit, përveç se është i kundërligjshëm, tregon qartë se është i motivuar nga interesa të tjera jashtë atyre ligjore, me qëllim të privimit të parashtruesit të kërkesës nga e drejta e tij për vlerësim të drejtë dhe të ligjshëm të ofertës brenda pritshmerive legjitime dhe në përputhje me nenin 59 dhe 60 të LPP, të cilët përcaktojnë kriteret e përgjegjshmërisë dhe kriteret për dhënien e kontratës.

14. Për këto arsye dhe në këto rrethana, rezulton se AK ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme duke tejkualuar dispozitat ligjore dhe nxjerrë vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga neni 62 i LPP dhe neni 43.5 i RRPP, duke tentuar t'i maskojë shkeljet e veta përmes një justifikimi artificial të krijuar në mënyrë fiktime që në kuptim juridik tejkalon karakterin ligjor dhe nuk mund të shërbejë si bazë për anulimin e një procedure prokurimi dhe që në thelb cenon rëndë parimet e barazisë, transparencës dhe trajtimit të drejtë e të ligjshëm.

Për më tepër, veprime dhe vendime të tilla, përveç që cenojnë të drejtat ligjore të operatorëve ekonomikë, mund të implikojnë përgjegjësi ligjore personale për zyrtarët përgjegjës, pasi përbëjnë tejkallim të diskrecionit administrativ në kundërshtim me qëllimin dhe frymën e legjislacionit të prokurimit publik. Kjo e bën të qartë se anulimi i procedurës nuk është rezultat i një situatë objektive dhe ligjore, por rrjedhë e drejtpërdrejtë e veprimeve të kundërligjshme për shmangien e dhënies së kontratës operatorit ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Shtojcë: Kundërshtim i arsyetimit të AK në përgjigjen ndaj këtij pretendimi dhe faktet e siguruara gjate procesit të qasjes zyrtare në të dhënat e aktivitetit.

15. Njësia e Prokurimit të AK nuk e ka shqyrtuar fare këtë pretendim ankimor të paraqitur në kërkesën për rishqyrtim, si dhe faktet dhe provat e dorëzuara në mbështetje të saj, për të cilat ka detyrë dhe obligim të drejtpërdrejtë sipas nenit 24 dhe nenit 108/A paragrafi 12 të LPP, në lidhje me nenin 48 të LPPA Nr. 05/L-031, në mënyrë që të respektojë të drejtat e ankuesit dhe të marrë një vendim të drejtë, të ligjshëm dhe në përputhje me pritjet legjitime dhe të arsyeshme të tij.

16. Mirepo, në vendimin me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e AK të datës 30.04.2026, Njësia e Prokurimit është mjaftuar me parafrazimin e të njëjtit arsyetim të përdorur tashmë në atë njoftim, duke theksuar se Njësia Kërkuese ka konfirmuar se nuk mund të vazhdohet me procedurën e prokurimit për shkak se nuk janë të përfshira të gjitha rrugët në pozicione dhe kërkesat e banorëve. Një arsyetim i tillë, i cili thjesht ripërsërit qëndrimin e mëparshëm dhe mbështetet në supozime dhe interpretime subjektive të Njesisë së Prokurimit, pa i analizuar konstatimet faktike dhe provat e paraqitura nga ankuesi, pa i vlerësuar faktet që rezultojnë nga shkresat e lëndës për të cilat Njësia e Prokurimit ishte në dijeni, dhe pa sqaruar shkaqet për të cilat i ka kundërshtuar si dhe bazën ligjore të qëndrimit të saj, nuk përbën shqyrtim meritore dhe bie ndesh me detyrimet e lartcekura ligjore.

17. Pavarësisht se është fakt notor që vendimi për anulim të aktivitetit të prokurimit në hapin e parafundit të procesit (vlerësimi dhe dhënia e tenderëve), siç përcaktohet në nenin 4.5 të UPP, bie ndesh dhe tejkalon kriteret ligjore të listuara në nenin 62 lidhur

me nenin 9 të LPP dhe nenin 43 të RRPP, nuk qëndron i saktë as justifikimi sipas rastit me imagjinimin e kesaj situatë se nuk janë të përfshira të gjitha rrugët sipas kërkesave të banorëve. Kjo vërtetohet edhe nga pergjigja e projektusit të projektit dhe njekohesisht nga aneksi i procesverbalit të qasjes në dokumentet zyrtare të këtij aktiviteti, sipas të cilit Njësia e Prokurimit e kundërshton vetveten, duke konfirmuar se nuk ekzistojnë kërkesa të banorëve për përfshirje të rrugëve të reja në projektin ekzistues dhe se nuk ekziston as plan i mobilitetit për rrugë të reja që i paraprin projektimit. Për më tepër, gjatë qasjes zyrtare kemi siguruar informacionin që konfirmon se AK - Komuna e Gjilanit, që nga data 16.08.2024 nuk ka kontratë aktive për hartimin e projekteve për infrastrukturë rrugore dhe investime kapitale në territorin e saj administrativ, fakt ky që e rrënon plotësisht justifikimin e përdorur "se ka kërkesa të banorëve për rrugë që nuk janë përfshirë në projekt" për anulimin e aktivitetit.

18. Për më tepër, edhe sikur të ekzistonte situata e pretenduar, një justifikim nuk qëndron as nga pikëpamja logjike dhe as jurisike sipas kriterëve ligjorë të LPP, si ligj material dhe legjislacionit sekondar RRPP. Ky justifikim bie ndesh me kërkesat e nenit 9 të LPP, i cili përcakton se para se të fillohet me ushtrimin e aktivitetit të prokurimit, vlerësimi i nevojave, rezultati dhe disponueshmëria e fondeve publike kryhet para inicimit të aktivitetit. Në rastin konkret, projekti është hartuar në vitin 2024, dhe vlerësimi i nevojave është kryer dhe dokumentuar në atë periudhë kohore, duke reflektuar rrethanat dhe nevojat e atëhershme. Ky inicim i këtij aktiviteti, duke përfshirë DNVDF i nënshkruar nga ZKA dhe ZKF, përfshirë mjetet në ligjin e buxhetit, konfirmon se nevojat e identifikuar janë të qarta, të arsyetuara dhe të mbështetura në dokumentacionin e autoritetit kontraktues në momentin e inicimit të aktivitetit. Andaj fakti që AK e ka iniciuar aktivitetin, ka hartuar dhe publikuar dosjen e tenderit, ka pranuar ofertat dhe ka vazhduar procesin deri në fazën e vlerësimit, dëshmon se AK vetë e ka konsideruar projektin të plotë dhe të realizueshëm. Për më tepër, çdo ndryshim i nevojave pas inicimit të aktivitetit nuk i atribuohet OE ankues, i cili ka vepruar në përputhje të plotë me kushtet e dosjes së tenderit siç ishin përcaktuar në momentin e publikimit. Rrethanat e vitit 2026 nuk mund të ndërliken dhe ngarkohen retroaktivisht mbi rrethanat dhe vlerësimet e kryera dhe të dokumentuara në vitin 2024. Ngase një justifikim i tillë bie ndesh me çdo logjikë njerëzore dhe pastaj juridike dhe profesionale.

19. Prandaj, justifikimi i Njesisë së Prokurimit paraqet një rast të krijuar artificialisht, me qëllim të vetëm parandalimit të shpërbimit me kontratë të OE ankues EL-BAU. Ky konstatim, ndër tjera mbështet nga fakti se komisioni i vlerësimit nuk e kishte miratuar me votë të mazhorancës raportin dhe rekomandimet për dhënien e kontratës OE ECO GROUP SH.P.K. **Ju lutem shihni si prove të bashkëngjitur raportin e komisionit vlerësues**

Ndërkohë kishin lindur edhe rrethana të reja, pasi OE ECO HOLDING GROUP që nga data 02.04.2025 nuk e kishte vazhduar validitetin e ofertës dhe sigurimin e tenderit në pajtim me nenin 29 dhe nenin 30 të RRPP. Kjo ka sjellë si rrjedhojë situatën juridike ku OE ECO HOLDING GROUP në asnjë mënyrë nuk mund të shpërblihet me kontratë, pasi në përputhje me keto dispozita operatorët ekonomikë që nuk e zgjasin validitetin e tenderëve të tyre refuzohen si të papërgjegjshëm.

Raste të tilla të krijuara artificialisht me imagjinimin e situatave fiktive, përbëjnë praktikë të shpeshtë dhe konsistente të AK për anulimin e aktivitetëve të prokurimit pas hapjes së ofertave dhe në fazën finale të dhënies së kontratës, përmes justifikimeve

të tilla apo të ngjashme. Për ilustrim, po sjellim dy raste konkrete me të cilat OE ankues EL-BAU është ballafaquar: *Renovimi i shtepse se kultures - Cernice - Ritenderim* me numer prokurimi 651-25-69478-5-2-1 dhe *Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadish, me numër prokurimi 651-22-11-628-521*

Pretendimi i tretë (Pretendimi i dytë i Kërkesës për Rishqyrtim)

20. Situata faktike dhe juridike e cekur më lart vërteton se vendimi i AK-së për anulimin e aktivitetit i nxjerrë në dëm të ankuesit, pa asnjë shkelje ligjore nga ana e tij dhe pa ekzistuar asnjëri nga kriteret e kërkuara nga neni 62 i LPP dhe neni 43 i RRPP, vendim i cili siç e kemi potencuar me larte konsiderojme se nuk është rastësor, por pjesë e një skeme të planifikuar, e cila shoqërohet me shkelje të tjera procedurale dhe materiale të LPP-së si ligj material dhe të RRPP-së si legjislacion sekondar i prokurimit, të cilat do të parashtrihen në vijim.

Së pari: Thirrja e ZPP-së në arsyetimin se Njësia Kërkuese ka konfirmuar pamundësinë e vazhdimit të procedurës për shkak se nuk janë të përfshira të gjitha rrugët në pozicione dhe kërkesat e banorëve, nuk përbën kriter ligjor për anulim sipas nenit 62 të LPP dhe veçanërisht **bie ndesh me kompetencat e Njesisë së Kërkesës të përcaktuara nga neni 10 i RRPP, i cili nga pika a) deri në pikën g) ka përcaktuar në mënyrë taksative të gjitha përgjegjësitë e kësaj njësie në raport me aktivitetet e prokurimit.** Në rastin konkret nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara me këtë dispozitë ligjore, çka do të thotë se arsyetimi i përdorur nga AK nuk ka bazë ligjore. Per me teper keto kompetenca nuk mund te zevendesohen apo tjetersohen ne menyre qe te krijohen rrethana apo situata sipas interesave te kujtdo çofte ne AK qe krijojne epersi apo standarde te ndryshme nga ato te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi. Një arsyetim i tillë përbën tentativë për të vënë në lajthim ofertuesit dhe organet e tjera përmes ngatërimit apo shtremberimit të gjendjes faktike, duke cenuar njëkohësisht interesin e operatorëve ekonomikë, interesin publik dhe funksionimin normal të shërbimeve, prandaj nje vendim i tille nuk mund të prodhojë asnjë efekt juridik të ligjshëm.

Së dytë: Për më tepër, arsyetimi i AK-së bie ndesh me Projektin Kryesor "Rrugët në fshatin Lipovic - Depce - Muçibabë", të hartuar në vitin 2022 nga kompania projektuese e kontraktuar nga vetë AK - Gjilan, në të cilin janë të përfshira të gjitha rrugët sipas detyrave projektuese të kërkuara nga AK dhe duke u bazuar në kërkesat dhe nevojat e banorëve. Ky projekt ka shërbyer si bazë për fillimin e këtij aktiviteti prokurimi, dhe të gjitha këto hapa janë ndërmarrë në përputhje të plotë me detyrimet ligjore konform nenit 8 dhe nenit 9 të LPP që AK i ka para fillimit të çdo aktiviteti prokurimi. Gjithashtu, mjetet financiare për realizimin e tij janë të siguruara dhe të dokumentuara në **Tabelën 4.2, Kodi buxhetor 53151, të Ligjit të Buxhetit për vitin 2026.** Prandaj, preteksti se nuk janë të përfshira kërkesat e banorëve nuk qëndron por bie në kundërshtim nga vetë veprimet dhe dokumentacioni i AK-së dhe nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për anulimin e këtij aktiviteti. Për më tepër ju lutem referoju projektit në fjalë. Ky pretekst është edhe më i paqëndrueshëm duke pasur parasysh se AK që nga gushti i vitit 2024 nuk ka të lidhur kontratë për hartimin e projekteve për infrastrukturë rrugore

dhe investime kapitale, dhe të njëjtin aktivitet e ka në procedurë vlerësimi që nga data e dorëzimit 28.04.2025. Nëse AK kishte shqetësime reale për përfshirjen e kërkesave të reja të banorëve, zgjidhja ishte finalizimi i kësaj procedure, jo anulimi i një aktiviteti prokurimi të planifikuar dhe të financuar në mënyrë të rregullt dhe ligjore. Për më tepër, nëse AK vlerëson se ka nevoja tjera që duhet përmbushur për rrugë të reja, legjislacioni i prokurimit ka të parashikuara apo në dispozicion mjetet tjera ligjore, ashtu që pas vlerësimit të nevojave, analizes së tregut, planit të mobilitetit që i paraprin projektimit të projektit dhe disponueshmërisë së fondeve të nevojshme, mund të iniciojë një aktivitet të ri prokurimi në procedurë të hapur ose të kufizuar, bazuar në rezultatet e vlerësimit formal konform nenit 9 të LPP, apo edhe në raste të justifikueshme të shfrytëzojë dhjetë përqind (10%) e vlerës së kontratës të mëhershme dhe të aplikojë nenin 35 të LPP. Prandaj, edhe kjo situatë, e vërteton se vendimi i AK është i kundërligjshëm, se është vendosur në dëm të parashtruesit të kërkesës në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 8, neni 9 lidhur me nenin 62 dhe dispozitave tjera relevante të LPP.

Së treti: Krahas tjerave, vendimi për anulimin e aktivitetit është nxjerrë edhe me shkelje flagrante të detyrimeve procedurale të parashikuara nga neni 59 par.1 dhe 4 lidhur me nenin 60 të LPP lidhur me nenin 39 në paragrafët 6, 7, 10 dhe 11 dhe nenin 40 në paragrafët 1, 6, 13 të RRPP, të cilat përcaktojnë formën, mënyrën dhe kriteret e vlerësimit të tenderëve. Në rastin konkret, AK i ka anashkaluar tërësisht detyrimet ligjore që dalin nga dispozitat e lartcekura, pasi nga vendimi i fundit i AK rezulton se nuk është bërë raport nga komisioni i vlerësimit arsyet mbështetëse për secilin tenderues, i cili është kusht i domosdoshëm procedural para nxjerrjes së çdo vendimi nga ZPP. Për këto arsye, vendimi i AK-së për anulimin e aktivitetit është i paligjshëm si nga ana materiale ashtu edhe nga ajo procedurale.

Shtojcë:

21. Njësia e Prokurimit të AK nuk e ka shqyrtuar fare këtë pretendim ankimor të paraqitur në kërkesën për rishqyrtim, si dhe faktet dhe provat e dorëzuara në mbështetje të saj, për të cilat ka detyrë dhe obligim të drejtpërdrejtë sipas nenit 24 dhe nenit 108/A paragrafi 12 të LPP, në lidhje me nenin 48 të LPPA Nr. 05/L-031, në mënyrë që të respektojë të drejtat e ankuesit dhe të marrë një vendim të drejtë, të ligjshëm dhe në përputhje me pritjet legjitime dhe të arsyeshme të tij.

Për faktet dhe provat konkrete që mbështesin këtë pretendim, referohuni shtojcës së pretendimit të mësipërm, të cilat zbatohen në të njëjtën mënyrë edhe për këtë pretendim. Me konkretisht referojuni faktit lidhur me anashkalimin flagrant të detyrimeve ligjore sipas nenit 39 par.10 dhe 11 të RRPP, pasi që komisioni i vlerësimit nuk e kishte miratuar me votë të mazhorancës raportin dhe rekomandimet e komisionit, ndërsa Njësia e Prokurimit, nuk mjaftohet me këto shkelje dhe me vonesa të pajustificueshme - mbi një vjeqare të procesit të vlerësimit, por vazhdon veprime tjera në kundërshtim me ligjin duke cenuar parimin e sigurisë juridike dhe parimin e ligjshmerisëshkelje të tjera. Dhe për më tepër, proven (aneksin e procesverbalit për qasje) ku AK e kundërshton vetveten e tij/saj, pasi konfirmon se nuk ka kërkesa të banorëve për përfshirje të rrugëve të reja në projektin egzistues dhe nuk ka as plan të mobilitetit për rrugë të reja që i paraprin hartimit të projektimit të projektit.

Për këto arsye, me anë të kësaj kërkesë, i drejtohem institucionit tuaj me qëllim që të ndalet këtu kjo paligjshmëri e qëllimshme dhe të anulohet vendimi në fjalë, në mënyrë që të garantohet e drejta e parashtruesit vetëm mbi bazën ligjore, në përputhje me vendimin e juaj të datës 06.04.2026, dy vendimet përfundimtare të OSHP, si dhe në përputhje me dispozitat relevante të LPP, RRPP, UPP dhe kufijtë e përcaktuar ligjor sipas Kodit Etik për të cilat jeni deklaruar nën betim.

3. Përfundim me propozime

Andaj duke marrë parasysh të gjitha arsyet, faktet dhe provat e paraqitura si më lart, OE ankues EL-BAU SHPK i drejtohet OSHP-së me këtë ankesë, duke kërkuar që pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, administrimit të shkresave të lëndës dhe provave në shqyrtim kryesor, e në pajtim me nenin 104, 105 dhe 107 dhe 117 të LPP-së, të merr këtë:

V E N D I M

22. **MIRATOHET E BAZUAR** në tërësi Ankesa e parashtruar nga OE EL-BAU SHPK;
23. **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e AK , i datës 30.04.2026, me të cilin AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi I rrugeve në fshatrat Lipovicë, Myqibabë dhe Depcë”
24. **OBLIGOHET** AK të vazhdojë menjëherë me procedurën ligjore për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e Tenderëve në pajtueshmëri me parimet themelore dhe dispozitat e nenit 59 dhe 60 lidhur me nenin 1,6,7 dhe 24 të LPP dhe dispozitave të ndërlidhura që rregullojnë situatat e tilla të RRPP

25.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Obligimit të kompensimit të shpenzimeve procedurale, kompensimit të dëmit, dhe fitimit të humbur që do kërkohet pastaj.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Në mbështetje të ankesës bashkëngjitet të gjitha provat e cekura.